



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/90 Nr. i faq/Br.str/No.pg 81

Data/Datum/Date 26.01.2026

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 24 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2.4, nenit 40 dhe nenit 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë: 26.1.2026 merr këtë:

V E N D I M

Për pagesën e mëditjeve të anëtarëve të Komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës

1. **MIRATOHET** vendimi për pagesën e mëditjeve të anëtarëve të të gjitha komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës në Rahovec.
2. Komisionet sipas pikës 1 të këtij vendimi do të paguhen në shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro) për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se 3 (tre) takime.
3. Pagesa e mëditjeve të komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës do të paguhet nga buxheti i Komunës së Rahovecit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Me vendim të njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- MAPL, dhe
- Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr. 90/26

Me datë: 26.01.2026



Fatmir Iska

Kryesues i Kuvendit